



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

27 nëntor 2020

Njoftim për media

Kumnova në mbështetje të thirrjes së RrGK-së për shkarkimin e Selmanajt

Drejtorja Ekzekutive e Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK), Igballë Rogova, edhe sot do të vazhdojë protestën për të kërkuar shkarkimin e zëvendëskryeministrit Driton Selmanaj, pas deklaratës së tij lidhur me çështjen e të pagjeturve.

Rogova, për të pestën ditë me radhë, duke filluar nga **ora 12:00** do të qëndrojë para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës, në sheshin **“Skënderbeu”** të Prishtinës. Mirëpo, kësaj radhe pankartën **“Selmanaj ik”** do ta mbajë në duar edhe Nesrete Kumnova, Kyetare e Organizatës **“Thirrjet e Nënave”**. Në fillim ato do të mbajnë 30 minuta heshtje, pastaj në ora **12:30** do të prononcohen për media.

Kumnova, e cila tashmë për dy dekada thërret për drejtësi për të pagjeturit, do të bashkëngjitet si përkrahje për thirrjen e RrGK-së dhe të qytetarëve që tashmë kanë nënshkruar petitionin online, në thirrjen për shkarkimin e menjëhershëm të Selmanajt.

Në [letren](#) që RrGK i ka dërguar kryeministrit Avdullah Hoti më 23 nëntor, kemi përmendur gjerësisht çdo arsye pse deklarimi i Selmanajt është fyerje për qytetarët dhe interesin e tyre.

Sot, prania e Kumnovës bart simbolikën e zërit të çdo familjeje të mbi një mijë e 600 personave që ende janë të pagjetur që nga lufta në Kosovë.

Ashtu si çdo ditë tjetër, edhe sot kjo protestë do të zhvillohet në përputhje të plotë me rregullat për luftimin e pandemisë COVID-19.

Ftohen mediat ta përcjellin këtë ngjarje.